REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 102/17
Datë/Datum. 12.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit **Komuna Novobërdë**	Kopje:	**Paneli Shqyrtues - OSHP**
Prej:	**Safije Saramati – Eksperte Shqyrtuese** **Besim Mulaj – Ekspert Teknik.**		
Lënda:	Ekspertiza Lidhur me Ankesat: **Nr. 102/17 e OE "Dromodoli Comerc" – Pejë,**		
Datë:	**12.05.2017**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me Nr. **102/17 e OE "Dromodoli Comerc" – Pejë**, për shqyrtimin e lëndës: **"Shitja e Masës drusore të pa prerë në njësim menaxhuese Novobërdë - Kodra e Madhe ,me lloj te trajtimit Rrallime" me nr. te prokurimit NB 654 / 17 / 001 / AP** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Novobërdë.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Komuna Novobërdë.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"Dromodoli Comerc" – Pejë**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		02.05.2017		05.05.2017		12.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 26.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me Nr. **102/17 e OE "Dromodoli Comerc" – Pejë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shitja e Masës drusore të pa prerë në njësim menaxhuese Novobërdë - Kodra e Madhe ,me lloj te trajtimit Rrallime" me nr. te prokurimit NB 654 / 17 / 001 / AP** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Novobërdë.**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Eksperti Shqyrtues-Teknik e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Novobërdë.**

N.111,LPP – Ankesa me nr. 102/17 nga OE **"Dromodoli Comerc" – Pejë**

*Pikat e Ankesës nga OE: **"Dromodoli Comerc" – Pejë** - dispozitat e shkelura nga AK:*

Neni 7 – Barazia ne trajtim – jo diskriminim
Neni 59 – Egzaminimi dhe Vleresimi i tendereve
Neni 60 – Kriteret per dhenje te kontrates
Neni 62 – Anulimi i AP

Jemi te diskriminuar me rastin e Anulimit te AP , sepse jemi OE i pergjegjshëm dhe i plotesojm kriteret sikurse ne njoftimin per kontrate ashtu edhe ne Dosjen e tenderit , prandaj jemi te diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar konform nenit 7 te Lpp-së

Nuk jemi njoftuar ne lidhje me Egzaminimin apo vleresimin e tendereve , AK nuk ka vepruar konform nenit 59 te Lpp-së

Ka OE te pergjegjshëm dhe nuk ka rrespektuar nenin 60 , si kriterin kryesor ne kete AP.

Shkelje e rendë e nenit 62 , ne asnje rrethanë , nuk mund te kete Anulim te AP , kur keni parasysh se keni 7 OE te cilet kane dorezuar Ofertat per kete AP , dhe ne mesin e tyre jemi edhe ne OE i pergjegjshëm , prandaj AP mund te anulohet vetem konform nenit 62 siq parashef si me poshtë :

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Pra ky ANULIM i AP nuk eshte konform Lpp-së e as nenit 62 , te perkufizuar se kur mund te anulohet nje Aktivitet i Prokurimit . Kryetari i Komunes eshte ZKA dhe ne asnje variant nuk duhet te dirigjoj apo te keshilloj ZP se si te veproj ne nje AP , e lere me te merr VENDIM ne bashkpunim me zyren e prokurimit per Anulimin e nje Aktiviteti te Prokurimit , pra ZKA ka kaluar te gjitha kopetencat ligjore dhe ka bere nderhyrje te drejtperdrejt ne pa-varesin e ZP.

Ne letren Standarte thuhet se AK ka Marrë Vendim per Anulim , pa sqaruar dhe pa u mbeshtetur ne nenin 62 te Lpp-së

Kerkojm qe Ankesa e jonë te Aprovohet si e Bazuar dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në Ri-Vlerësim

Neve si OE na eshte shkaktuar nje deme i konsiderueshem materiale , sepse sikurse ta fitonim kete tender do te kishim lenden drusore per sektorin e prodhimit me te cilin e kemi si aktivitet primar, Duke pritur me shume se 40 dite ne nuk kemi qene ne gjendje qe te furnizohemi nga ndonje furnitor tjeter duke pasur parasysh se po qe se shpallemi fitues te kesaj kontrate na lindin edhe obligimet financiare per realizimin e saj , kemi qene te detyruar te presim gjate gjithe kesaj kohe per te realizuar kontraten e cila me siguri qe do te na sillte perfitime materiale sikurse edhe pagesen e te punesuarve ne kompanin tone.

Jemi te demtuar edhe ne pergaditjen e dosjes se tenderit si dhe shpenzime te ofertimit .

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	12.01.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Ankand Publik
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë 17 ditë):	10.02.2017
Data e hapjes së ofertave	10.02.2017-12:15h
Kriter për dhënie të kontratës:	*Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të lartë*
Lloji i kontratës:	Ankand Publik

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (Neni 60):

Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të lartë

III.2. – KUSHTET PER PJESEMARRJE

Masat drusore do ti shitet ofertuesit që ofron çmimin më të lartë dhe që plotëson të gjitha kriteret e kërkuara

Ofertuesit duhet te posedojne:

a) Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit,dhe Numri fiskal

b) Dëshminë për përgatitjen profesionale dhe teknike- licencën(Valide) për kryerjen e aktiviteteve përkatëse sipas UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 14/2011 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2010 për mënyrën dhe procedurat e shitjes së trungjeve pyjore dhe asortimenteve drunore nga pyjet publike, të dt. 28.06.2010

c) Çertifikatën mbi kryerjen e obligimeve tatimore nga Administrata Tatimore e Kosovës jo më të vjetër se tre muaj, nga dita e aplikimit ,Deshmi e pageses se Tatimit ne pron ne emer te pronarit te Kompanis (**duhet dorëzohen nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës,)**

d) Dëshmi të lëshuar nga Autoriteti Pyjor Komunal në Novobërd, dhe Agjencioni Pyjor i Kosovës,Drejtoria Koordinuese Gjilan ,se kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pa kryera nga kontrata të mëhershme.

e) Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit të themeluesit të Tenderuesit (Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike) se Tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me kërkesat nga FTD, neni 6 pika 6.3 të dosjes së tenderit. (jo me dt. më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e fundit të dorëzimit të tenderit. (**duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës**,) të dorëzohet në (Origjinal ose kopje e vërtetuar)

- **Kriteret vijuese që do të kërkohen për vlerësimin e tenderit janë:**

a) Çmimi më i lartë i ofruar vendos fituesin e tenderit.

b) Referencë-dëshmi mbi kryerjen me sukses të punëve të realizuara nga kontratat e më hershme ne tri vitet e fundit se paku dy e hartuar sipas procesverbalit të komisionit për pranim- dorëzimin e ngastrave pyjore sipas nenit 45 paragrafi 2 të U.A nr;29/2005,
c) Dinamika propozuar për kryerjen e punëve por jo më shum se 112 dit pune .
d) Lista e paisjeve (mjeteve te punes) qe posedon kompanija
e) Lista e Stafit qe do te angazhohen ne këtë aktivitet

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatori ekonomik	Selia e OE-s	Çmimi i ofertës/në euro
1	NPT DROMODOLI COMERC	Pejë	18,575.60
2	NTP VLLASALIA	Novobërdë	22,045.70
3	SHPK SALEX	Pejë	22,484.16
4	NT DAJA	Prishtinë	19,940.22
5	NTSH BUJARI	Viti	18,714.70
6	NTP VLLEZERIT MEHMETI	Gjilan	25,688.08
7	NTSH NAZI TRAVEL & NTSH BERVENIKU	Prishtinë	18,368.15

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin e vleresimit në përbërje prej pesë anëtarëve, si në vijim:

1.Avdi Vllasaliu - Kryetar i komisionit,
2.Predrag Stankovic - Anëtar i komisionit,
3.Driton Hyseni -Anëtar i komisionit,

Data e mbarimit të vlerësimit: 14.02.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....23.03.2017

Data e njoftimit të Anulimit së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....23.03.2017

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, ankand publik, dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lartë.

PERGJIEGJET E EKSEPRTIT SHQYRTUES - TEKNIK NE LIDHJE ME PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES: "Dromodoli Comerc" - Pejë.

Sqarimi nr.2

Lidhur me anulimin e këtij ankandi publik nga AK-Komuna Novobërdë sqarojmë se anulimi nuk është bere ne përputhje me LPP,përkatësisht neni 62 te përkufizuar se kur mund te anulohet një Aktivitet i Prokurimit (ankandi publik).

Sipas pikes se ankeses Kryetari i Komunës është ZKA dhe ne asnjë variant nuk duhet te dirigjoj apo te këshilloj ZP se si te veproj ne një AP , e lere me te merr VENDIM ne bashkëpunim me zyrën e prokurimit për Anulimin e një Aktiviteti te Prokurimit , pra ZKA ka kaluar te gjitha kompetencat ligjore dhe ka bere ndërhyrje te drejtpërdrejt ne pa-varësin e ZP,pra ne asnjë rrethanë nuk parashihet anulimi ne baze te vendimit te ZKA-se por ne nenin 62 parashihen rrethanat ne cilat raste mund te behet anulimi i një AP si me poshtë:

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo **duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.**

Pra duke pa rrethanat e cekura me larte ne nuk kemi asnjërën nga këto rrethana për te bere anulimin atëherë AK nuk ka respektuar ketë dispozite për anulimin e këtij ankandi publik.

AK ne njoftimin për anulim ka cekur se një një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit pa cekur se cila është ajo dispozitë ndërsa te sqarimi ne njoftimin për anulim te këtij AP sqaron se anulimi është i nevojshëm pas kërkesës se komisionit vlerësues qe ky AP të anulohet për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit e qe janë dhënë detajet te hollësishme nga komisioni i vlerësimit ku ky i fundit pas rrethanave te krijuara nga frika e dëmtimit te buxhetit dhe diskriminim te OE pjesëmarrës ne këtë AP ka kërkuar qe ky aktivitet i prokurimit te Anulohet.

AK ne ketë AP ka vlerësuar ofertat dhe sipas raportit te komisionit te vlerësimit eshte kërkuar anulimi

i këtij AP dhe ne ketë rast AK e sidomos ZKA ne kundërshtim me dispozitat ligjore te nenit 62 ka bere anulimin e këtij AP sepse kjo është dashtë te behet tri (3) dite para hapjes e jo pasi qe është bere hapja dhe vlerësimi i ofertave te behet anulimi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Novobërdës, për ankandin publik me nr. te prokurimit **NB 654 / 17 / 001 / AP**, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,konkretisht Nenin 62 andaj i **propozon panelit shqyrtues që te aprovon ankesën e OE ankues, te anulojë vendimin e AK-së për anulimin e ankandit publik si dhe ky aktivitet i prokurimit të Ri-Vleresohet.**